FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

PARACETAMOL

Tableta – 500 mg
Supozitorë – 100 mg, 125 mg ose 250 mg
Shurup – 120 mg / 5 ml
(Paracetamol)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Paracetamol dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Paracetamol
3. Si ta merrni Paracetamol
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Paracetamol
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË PARACETAMOL DHE PËRSE PËRDORET

Vendi dhe mekanizmi i efektit analgjezik të paracetamolit nuk janë sqaruar plotësisht. Paracetamoli e ul temperaturën duke vepruar drejtpërdrejt në qendrën e rregullimit të temperaturës në hipotalamus; kjo qendër e fuqizon proçesin e uljes së temperaturës me anën e zgjerimit të enëve periferike të gjakut dhe me anë të djersitjes. Paracetamoli është po aq i efektshëm sa edhe aspirina përsa i përket frenimit të prostaglandinë -sintetazës në sistemin nervor qendror, por frenimi periferik i sintezës së prostaglandinës është minimal, gjë së cilës mund t'i detyrohet mungesa e efekteve antireumatike ose antiinflamatore, që janë me rëndësi klinike. Efeket analgjezike e antipiretike të paracetamolit, në përgjithësi janë të krahasueshme me ato të aspirinës, por aspirina ka efekt shumë më të mirë se paracetamoli kundër dhimbjes me origjinë inflamatore. Paracetamoli nuk e frenon agregimin e trombociteve dhe nuk shkakton ulçera në aparatin tretës.
Paracetamol indikohet si analgjezik dhe antipiretik i përshtatshëm sidomos për të sëmurët e ndjeshëm ndaj aspirinës, për të sëmurët me çrregullime në koagulimin e gjakut ose me ulçer të stomakut:

- në dhimbjet me intensitet të ulët ose mesatar, me lokalizime të ndryshme (dhimbje koke, dhimbje dhëmbi, nevralgji, mialgji, dhimbje menstruale, dhimbje pastraumatike e pasoperatore);
- për uljen e temperaturës në gjendjet me ethe.

2. PËRPARA SE TË MERRNI PARACETAMOL

Mos merrni Paracetamol në qoftë se keni:

- mbindjeshmëri ndaj lëndës aktive ose ndaj çdo përbërësi tjetër të barit;
- dëmtim të rëndë të funksionit të mëlçisë dhe të veshkave;
- dëmtime të kokës dhe të trurit;
- tension të lartë intrakranial;
- pamjaftueshmëri gjenetike të glukozë - 6 - fosfat dehidrogjenazës;
- çrregullime të frymëkëmbimit.

Tregoni kujdes të veçantë me Paracetamol

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Paracetamol.
Duhet treguar kujdes:

- në të sëmurët me insufiçiencë të lehtë renale ose hepatike;
- në alkoolistët;
- në të sëmurët që vuajnë nga dehidratimi ose kequshqyerja kronike;
- në periudhën e shtatzënisë dhe atë të ushqyerjes së fëmijëve me gji;
- gjatë përdorimit afatgjatë; në këtë rast duhen kryer provat për funksionin e mëlçisë.

Gjatë trajtimit me paracetamol, përpara se të merrni çdo bar tjetër, kontrolloni që të mos përmbajë të njëjtën lëndë aktive, duke qenë se doza të larta të paracetamolit mund të shkaktojnë efekte anësore serioze.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga paracetamoli.
Ju lutemi të kontaktoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Paracetamol në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit, sidomos këta të mëposhtmit:

- barbituratet;
- hidantoinat;
- izoniazidi;
- karbamazepina;
- rifampicina;
- sulfinpirazoni;
- alkooli etilik;
- karboni aktiv;
- varfarina;
- busulfani intravenoz;
- kolestiramina;
- metoklopramidi;
- zidovudina;
- kloramfenikoli.

Shtatzënia dhe ushqimi me gji

Paracetamol duhet të përdoret sipas këshillës së mjekut gjatë shtatzënisë dhe ushqimit me gji. Duhet të dini se paracetamoli kalon në qumështin e gjirit.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Paracetamoli nuk ndikon në drejtimin e automjetit dhe përdorimin e makinerive.

Informacione të rëndësishme mbi disa nga përbërësit e Paracetamol

Paracetamol - shurup përmban:

- sorbitol; nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar;
- metilhidroksibenzoat, që mund të shkaktojë reaksione alergjike (ndoshta të vonuara).

3. SI TA MERRNI PARACETAMOL

Gjithmonë merreni Paracetamol sipas këshillës së mjekut ose farmacistit. Konsultohuni me mjekun ose me farmacistin tuaj në qoftë se nuk jeni i sigurt.

- Tabletat merrini nga goja. Gëlltiteni çdo tabletë me ujë.
- Supozitorët janë vetëm për administrim rektal.
- Shurupi merret nga goja me lugë çaji (5 ml).

Administrimi oral

Tabletat:
Të rriturit: nga 0.5 - 1 g, 3 - 4 herë në ditë. Doza maksimale ditore për mjekimin afatshkurtër është 4 g, kurse për mjekimin afatgjatë 2.5 g.
Adoleshentët 12 – 15 vjeç: 1 tabletë, e cila mund të përsëritet pas 4 – 6 orësh. Nuk duhet të tejkalohen 4 doza në ditë.
Fëmijët 6 – 12 vjeç: nga ½ tablete, 3 – 4 herë në ditë.
Fëmijët nën 6 vjeç: nuk rekomandohet përdorimi i tabletave.

Shurupi:
Fëmijët 2 - 3 muajsh: 2.5 ml shurup është i përshtatshëm për foshnjet që bëjnë vaksinën në muajin e dytë, në rastet e tjera përdoret nën kujdesin mjekësor.
Fëmijët 3 – 12 muajsh: 2.5 – 5 ml (60 - 120 mg paracetamol) çdo 4 – 6 orë, me një dhënie maksimale 4 herë në 24 orë.
Fëmijët 1 – 6 vjeç: 5 – 10 ml (120 - 240 mg paracetamol), çdo 4 – 6 orë, me një dhënie maksimale 4 herë në 24 orë.

Administrimi Rektal (Supozitorët):

Supozitorët Paracetamol duhet të merren gjithmonë sipas këshillave të mjekut ose farmacistit tuaj.
Doza rektale në të rritur dhe në fëmijët mbi 12 vjeç: 0.5 – 1 g çdo 6 deri 8 orë pa kaluar në 4 g në ditë.
Në mjekimet e zgjatura jo më shumë se 2.6 g në ditë.

Në fëmijët: 60 mg si dozë antipiretike pas vaksinave në fëmijët 2-muajsh. Në raste të tjera, fëmijët më të vegjël se 3 muajsh vetëm me këshillën e mjekut.
3 - 11 muaj: 60 - 125 mg çdo 4 - 6 orë sipas nevojës, maksimumi 4 doza në ditë.
1 - 4 vjeç: 125 - 250 mg çdo 4 - 6 orë sipas nevojës, maksimumi 4 doza në ditë.
5 - 11 vjeç: 250 - 500 mg çdo 4 - 6 orë sipas nevojës, maksimumi 4 doza në ditë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Paracetamol

Në qoftë se keni marrë më shumë Paracetamol se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Simptomat e mbidozimit përfshijnë: nauze, të vjella, anoreksi, dhimbje abdominale dhe dëmtim të rëndë të mëlçisë.

Në qoftë se harroni të merrni Paracetamol

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Paracetamol mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Njoftoni mjekun tuaj për efektet anësore të mëposhtme që mund t'ju shfaqen:

- anemi hemolitike, neutropeni, leukopeni, pancitopeni, trombocitopeni, agranulocitozë;
- rritje e transaminazave, ikter;
- hipoglicemi.

Në raste shumë të rralla janë raportuar reaksione serioze në lëkurë.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI PARACETAMOL

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Paracetamol pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Paracetamol

Lënda vepruese është paracetamoli.

- Një tabletë përmban 500 mg paracetamol.

Përbërësit e tjerë: celulozë mikrokristalore, glikolat natriumi i amidonit, talk, stearat magnezi, dioksid silici koloidal.

- Një supozitor përmban 100 mg, 125 mg ose 250 mg paracetamol.

Përbërës të tjerë: dioksid silici koloidal dhe yndyrna të ngurta.

- 5 ml shurup përmbajnë 120 mg paracetamol.

Përbërës të tjerë: sorbitol, propilenglikol, ciklamat natriumi, sakarinë natriumi, citrat natriumi, metilhidroksibenzoat (nipaginë), povidon, glicerinë, sulfat magnezi, alkool etilik, esencë mandarine, karminë (E 120), dhe ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit

Tabletat - kuti me 20 ose 60 tableta.
Supozitorët (100 mg, 125 mg ose 250 mg) - kuti me 10 supozitorë.
Shurupi - kuti me një shishe qelqi 100 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Mund të merret pa recetën e mjekut.

Kujdes me dozën.

Kujdes gjatë shtatzënisë.

Përmbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Supozitorë.

Shurup.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Korrik 2016.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.